

Plehrimi I Mjadrës

Mjedra plehërohet me plehra të kombinuar si:

1. Përdorimi i plehut të stallës.
2. Shpërndarja e plehrave mineralë në formë kokrrash.
3. Me plehra të tretshëm në ujë dhe kristalorë me sistem të ujitjes.
4. Përdorim të mikro elementeve nëpërmjet plehimit gjethor.

Pjesa më e madhe e plehërimit nga të gjitha metodat varet nga përmbajtja e lëndëve ushqyese në tokë, natyra e tokës dhe potenciali ekzistues i sistemit për ujitje. Nëse nuk ekziston sistemi ujitës plehërimi mund të bëhet me shpërndarjen e plehut të stallës dhe shpërndarjen e kokrrave të plehut artificial .

Ujitja e Mjadrës

Sistemi klasik i ujitjes me pika është sistemi nga i cili uji lirohet në afërsi të bimës. Ky sistem përdoret në vende të pjerrëta dhe ka për qëllim shpërndarjen e mirë të ujit.

Nuk rekomandohet:

Ujitja me ujë të shpejtë, por ujitja bëhet me ujë ngadalë në mënyrë që toka ta thithë të gjithë sasinë e ujit. Ujitja me sasi të tepruar të ujit mund të jetë e dëmshme, prandaj duhet pasur kujdes në këtë drejtim.

Nuk rekomandohet:

Ujitja e kultivarëve dyvjeçar të mjadrës (Willamette, Mikeer, etj.), kryhet vonë në verë dhe në vjeshtë, sepse frenohet pjekja e plotë e lastarëve dhe mos përgatitja e tyre për dimërim.

Kultivarët kryesor të mjadrës

Willamette



Willamette: Është kultivar kryesor i mjadrës. Frutat vilen lehtë. Të përshtatëshme për konsumim në gjëndje të freskët.

Polka



Polka: Kultivar që jep rendimente të larta dhe cilësorë.

Meeker



Meeker: Rekomandohet për kultivim në rajone të rrafshëta dhe për fusha intensive me mjadrë.



**ONDRA E TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
VLORE**



KULTIVIMI I MJADRËS

**QTTB VLORE: SHAMOGJIN
NOVOSELË - BASHKIA VLORE
BASHKIA VLORE**

PSE DUHET TË KULTIVOJME MJEDRËN?

Në krahasim me shumë pemë të tjera, mjedra ka disa përparësi si:

- Mund të kultivohet në toka pak më të dobëta.
- Nuk ka kërkesa të veçanta klimatike.
- Jep prodhim të rregullt e të shpejtë.
- Mundëson qarkullimin e shpejtë të kapitalit.
- Rreziku i prodhimit është i vogël.
- Teknologjia e prodhimit është e thjeshtë.
- Është kulturë intensive që mundëson punësimin e një numri të konsiderueshëm si; (femra, fëmijë, njerëz të moshuar etj.,).

KËRKESAT PËR KLIMË DHE TOKË TË MJEDRËS

Toka: Për kultivim të suksesshëm, mjedrës i përgjigjen tokat me shtresën punuese të thellë mbi 1 metër, të shkrifët, të përshkueshme nga uji. Tokat malore dhe aluviale (ranore), janë tipat më të favorshme për kultivimin e mjedrës. Tokat skeletore dhe tokat e rënda janë toka të papërshtatshme për kultivim të mjedrës.

Për kultivim të suksesshëm të mjedrës më të përshtatshme janë rajonet me klimë mesatare, temperaturë mesatare mujore rreth 10 °C, reshje vjetore 800 - 1000 mm, shpërndarje të rregullt të tyre dhe me verë të freskët. Rekomandohet që rajonet më të favorshëm për kultivimin e mjedrës të zgjidhen në lartësi mbi nivelin e detit 1000 m, afër maleve, të dominuar me dru ahu.

SHUMËZIMI I MJEDRËS

Mjedra shumëzohet në shumë mënyra, por në praktikë përdorim më të shpeshtë janë dy mënyra: - **Shumëzimi me fidanë të rrënjëve;** - **me lastarë të pjekur dhe lastarë të gjelbër.**



NGRITJA E FUSHAVE ME MJEDËR (KRITERET)

1. Zgjedhja e vendit

Për kulturën e mjedrës tokat më të mira janë: Ranore argjilore ose vetëm argjilore dhe të kultuara argjilore

2. Zgjedhja e materialit riprodhues

Fidani standard i mjedrës duhet të jetë 50 cm i gjatë, mesatarisht i trashë 8 - 12 mm, me sistemin rrënjor jo më pak se 8 - 10 rrënjë kryesore, me gjatësi 12 - 20 cm, trashësi 2 mm, me rrënjëza dhe qimëza anësore.


Gjatë ngritjes së fushave me mjedër nuk përdoret materiali me prejardhje nga rritjet e pemishteve të vjetra prodhuese, sepse materiali i tillë mund të jetë i infektuar, si dhe me potenciali të zvogëluar prodhues.

Materiali nga pemishtet e vjetra prodhuese mund të jetë me prejardhje nga farërat që kanë rënë në tokë dhe nga ato janë formuar bimët të cilat kanë humbur veçoritë e pastra të llojit

Teknika e mbjelljes së mjedrës

Mjedra mbillet në ngastra të sheshta. Në tokat me drenazhim të dobët duhet të mbillet në lehe (vllaja), të ngritura me dimensione në lartësi 25 cm dhe gjerësi 60 cm.

Fidani mbillet në gropë në thellësi 3-4 cm me thellë se në fidanishte.



Sistemi rrënjor i pa shkurtuar


Sistemi rrënjor i shkurtuar

Zhytja e lastarëve

Sistemi i kultivimit të mjedrës


Ekzistojnë dy sisteme të kultivimit të mjedrës:

- me kaçubë;
- sistemi shpalier i cili mund të jetë shpalier vertikal dhe shpalier V.



Sistemi shpalier vertikal për fushat prodhuese të mjedrës sot paraqet sistemin standard më të mirë për kultivimin e kësaj kulture.

Shërbimet pas vitit të parë



Punimi i tokës, kontrolli i barërave konkurrues, plehërimi, ujtitja.

Në pranverë në fillim të vegetacionit (viti i shfrytëzimit) bëhet rrallimi i lastarëve në mënyrë që deri në bazament mënjanohen lastarët e dobët, të thyer, të papjekur në shkallë të duhur, lihen ata më të mirët. Numri i lastarëve të lënë në gjatësi një metër është 6-7, kurse te kultivari Meeker ky numër sillet deri 5 lastarë. Pas rrallimit lastarët e lënë lidhen në tel.